



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **12.03.2020** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës **Smajl Latifi**. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z.Fazli Morina, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezentë këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, OSBE, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga Plani vjetor i punës për vitin 2020, i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Ky është takimi i dytë për vitin 2019 i KKSB-së. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Trotualet, lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese,
 - Qentë endacakë,
Siguria në trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
3. Organizimi i takimit publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,
4. Të ndryshme.

Kryetari – Ky rend ditë, po ju vë në dijeni është në përputhje me planin e KKSB-së për vitin 2019, nëse nuk ka ndonjë koment për ndonjë pikët e rendit të ditës atëherë e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e vë në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari – Siç e dini ne tash nuk e kemi paraparë në rendin e ditës por unë po e filloj fjalën time me një situatë që besoj që tash jemi në dijeni të gjithë që është temë pothuajse globale nga Corona virusi që është prezent në shtetet përreth Republikës së Kosovës. Edhe ne si shtet po përpiqemi që të marrim masa preventive me qëllim të luftimit më me sukses të kësaj sëmundje e cila në shumë vende të botës ka marr edhe jetë njerëzish. Natyrisht dje ishte mbledhje e jashtëzakonshme e Qeverisë së Republikës

së Kosovës dhe në bazë të orientimeve dhe rekomandimeve apo planit operativ të përgatitjeve e masave dhe veprimeve që i ka marr Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Natyrisht edhe ne si komunë e Rahovecit në bashkëpunim me Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare kemi ndërmarrë masat sipas mundësive tona duke ju përmbajtur rekomandimeve ose kërkesave e nevojave që i ka parashtruar Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe ne tashmë e kemi edhe si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare edhe si komunë një plan operativ i cili nënkupton angazhime, aktivitete të cilat do të ndikojnë ose do të na mundësojnë që të jemi më të organizuar në rast se do të kemi ndonjë situatë të paraqitjes së ndonjë qytetari qoftë të komunës tonë apo të komunave tjera me Coronavirus.

Siç e dini nga dita e sotme është pezulluar edhe procesi edukativo arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit rrjedhimisht edhe në komunën tonë, sipas vendimit të qeverisë deri me 27 mars të këtij muaji nuk do të kemi mësim në shkollat tona. Ne presim me marr edhe furnizime tjera nga Ministria e Shëndetësisë, pajisje edhe elemente të tjera të cilat janë të nevojshme që stafi jonë i Shëndetësisë Primare të jetë më i përgatitur ose më i aftë që ta përballojë eventualisht paraqitjen e kësaj sëmundje ose të këtij virusi. Po ashtu ne edhe si administratë komunale jemi në kontakt ose në komunikim dhe në përputhje me rrethanat konkrete edhe rekomandimet kuptohet në bazë të një komunikimi ndër institucional do të jemi të gatshëm t'i kryejmë detyrat tona, përgjegjësitë tona sipas asaj që ne e vlerësojmë si administratë komunale në bashkëpunim me qeverinë, Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Policinë e Kosovës, inspektorët edhe gjithë mekanizmat që mund të jenë pjesë e një projekti për përballimin e suksesshëm të paraqitjes eventuale të këtij virusi në Republikën e Kosovës. Deri më tani nuk kemi asnjë rast në Komunën e Rahovecit dhe sipas informatave zyrtare nuk kemi asnjë rast as në Republikën e Kosovës e kjo është një lajm i mirë, nuk ka asnjë arsye edhe nuk ka hapësirë që të promovojmë politika që shpërndajnë frikë ose krijojnë frikë dhe mosbesim në institucionet tona dhe në kapacitetet që i ka shteti ynë për me u përball me sukses me këtë lloj sëmundje. Ajo që po dua me theksua në këtë takim edhe po dua me nda me ju si anëtare të KKS-së është një vrapim i bizneseve pra disa biznese për t'i ngritur çmimet edhe në komunën tonë. Për bindjen tonë edhe në cilësinë e Kryetarit të Komunës si udhëheqës i qytetareve të komunës së Rahovecit, ne jemi të shqetësuar nga veprimi i këtyre bizneseve për rritjen e çmimeve të materialit ushqimor dhe kjo ngritje e çmimeve është e turpshme për veprimin e tyre dhe e paarsyeshme se si një supë nga 0.35 cent me rritë në 0.90 cent pra është e turpshme ata që e bëjnë këtë punë dhe ne nuk e di se si do të veprojmë por do ta ftoj inspektoratin dhe policinë se paku me marr evidencë pastaj do të shohim se a do të ketë ndonjë masë administrative ndaj atyre bizneseve të cilat e shfrytëzojnë situatën e krijuar, krijojnë njëfarë paniku dhe i trefishojnë çmimet dhe këto produkte i shesin qytetareve të vet. Pra kjo është e papranueshme dhe kështu kanë vepruar disa matrapazë edhe në kohën e luftës dhe unë nuk po dua me i cilësua me një epitete të tillë askënd por është e turpshme ajo që bëjnë sot bizneset tregtare për rritjen e çmimeve me vlerë stratosferike. Ne do të shohim me vëmendje edhe me kujdes do të ftoj inspektorët tanë, Policinë e Kosovës dhe do ta monitoroj me shumë kujdes dhe krejt çka mundemi me bo ne që ta kemi një data bazë të dhënave dhe do të shohim që këto biznese kujt po i shërbejnë këto ditë të vështira si me ngritje të çmimit të miellit, vajit dhe gjitha produkteve ushqimore dhe duke krijuar njëfarë paniku që të merrni ushqim sa ma shumë. Ne jemi organizëm i gjallë pasi jeta vazhdon, nuk varet nga ne se sa kemi me jetue dhe sa do të zgjasë kjo situatë por ne mendojmë se edhe shteti jonë me kapacitetet që i ka do të mund të përballë dhe do të izolojë maksimalisht paraqitjen eventuale të këtij virusi që u përhap me shpejtësi në disa vende të botës por edhe në vendet përreth neve. Natyrisht po e përsëris ne do të kujdesemi që këta tregtarë që i shfrytëzojnë situatat e tilla ti dimë se kush janë dhe pse po e bëjnë këtë punë në një kohë kur realisht kërkohet solidaritet, angazhim vullnetar i njerëzve, kërkohet me dhanë maksimumin për shkak se ne po flasim për një sëmundje e cila po kërcënon njerëzit pra qytetarët e botës d.m.th. jo tash me shfrytëzua këtë kohë për përfitime kolosale në një situatë e cila u deshtë me qenë krejt e kundërta e jo çfarë po e bëjnë. Ky fenomen është edhe në komunën e Rahovecit dhe në gjithë komunat e Republikës së Kosovës. Ne po flasim për

komunën tonë dhe tërheqim vërejtjen shumë serioze për bizneset të cilat i shfrytëzojnë këto situata. Ne kemi përvojën edhe të luftës edhe dimë që disa njerëz që kanë deshtë me përfitua edhe në luftë dhe kanë bashkëpunuar edhe me policinë e ushtrinë serbe që ka bo krime në këtë vende edhe kanë shitë duhan, miell e shumë produkte të cilat natyrisht ka pasur nevojë imediate qytetari ynë. Nuk është situata e njëjtë mirëpo nuk është mirë me pas çasjen e njëjtë si dikur sepse ajo kohë ka kaluar dhe Kosova është e lirë dhe është shtet dhe ne kemi nevojë për solidaritet sot për shkak se situata në të cilën gjendemi edhe për shkak të përhapjes së këtij virusi duhet të na tërheq vëmendjen që të jemi më të përgjegjshëm, me të vetëdijshëm edhe me të ndërgjegjshëm edhe të kemi me shumë vullnet e përkushtim për tu përballur se bashku edhe institucionet edhe shoqëria civile edhe qytetaret edhe bizneset për t'i tejkaluar me lehte këto situata. Ne do të shohim mundësinë edhe të evitimit të respektimit të masave dhe rekomandimeve që i ka dhënë Qeveria e Kosovës, do të shohim mundësitë me i respektua maksimalisht edhe tubimet publike që mund t'i kemi pasi edhe ky është një takim publik pra do të shohim me i respektuar maksimalisht të gjitha rekomandimet të cilat burojnë prej vendimit të qeverisë së Kosovës, ku janë një varg masash që duhet me i respektua që të gjithë nga kryetari i komunës dhe secili qytetarë tjetër i kësaj komune. Pra si konkluzë, në pikën e Corona virusit deshta me kërkuar nga inspektorët me tërheq vëmendjen, me marr shënime se kush janë ato biznese të cilat i kanë ngritur çmimet apo i kanë dyfishuar çmimet dhe i shesin produktet qytetareve me çmime të cilat në 24 orë me herët ishin ndryshe kurse pas 24 orë me vonë janë dyfishë më shtrenjtë dhe ky fatkeqësisht është shqetësim besoj i të gjithëve, edhe i imi edhe i plot njerëzve që po i dëgjoj po ashtu edhe nga mediat dhe unë nuk e di si nuk kanë turp atyre që po i bëjnë këto punë. Për ndryshe përkundër gjithë kësaj që e thash, mendoj që situata politike dhe e sigurisë në komunën e Rahovecit është stabile, e qëndrueshme dhe pavarësisht që kemi një situatë si p.sh. mbrëmë në orët e vona që sigurisht do të na informoj edhe komandanti i stacionit të Policisë, kapiteni Fazli Morina që ka pasur një vjedhje dhe një djegie të shtëpisë që është mërgimtarë këtu në qytetatin e Rahovecit, përkundër që kemi kështu situata pra elemente keqbërëse, unë besoj thellë që situata e sigurisë pra situata e përgjithshme e sigurisë është e qetë dhe stabile në komunën e Rahovecit. Për më shumë, i kemi trotualet, lirim i tyre, shenjat sinjalizuese, qentë endacakë, siguria në trafik, monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, zbatimin e planit për siguri në shkolla si dhe rreth masave dhe veprimeve kundër atyre që e shkelin ligjin dhe bëjnë probleme. Këto tema për trajtim me siguri pas informacionit ose pas komenteve që do të jap komandanti i stacionit të Policisë, ne do të kemi mundësi me i debatua bashkë. Faleminderit, nëse jeni dakord unë do ja jap fjalën kapitenit Fazli Morina.

Kapiteni Fazli Morina – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Ashtu siç e tha edhe kryetari, gjendja shqetësuese edhe pa me alarmante është çështja e ngritur nëpër të gjitha shtetet e botës, edhe pse në shtetin tonë ende nuk kemi ndonjë rast të paraqitur për fatin e mirë. Dihet vendimin që e ka marr dje qeveria, tek ne sot ka ardhur një planë operativ dhe është në përpunim e sipër dhe ndërkohë brenda ditës me siguri do të marrim edhe veprime të sakta se çka do të veprohet dhe cilat do të jenë masat që do të ndërmerret, do të shohim në vazhdim që do të vjen nga drejtorja e përgjithshme e Policisë në Prishtinë, edhe pse prape mund të them se nuk është aq shqetësuese sa po bëhet propagandë ndërsa rreth çështjes tjetër nuk kam çka të flas se nuk është veç në komunën e Rahovecit por është në të gjitha qytetet e Kosovës, ka ngritje të çmimeve, shitoret janë të zbrazura, miell nuk gjendet askund, te paktën sa ne kemi informata dhe sa kemi shikuar ne, është gjendje alarmante rreth furnizimit me mallra të ndryshme dhe kjo le të mbetet në ndërgjegjen e tyre, do të ishte mirë me pas një statistikë që me pas informata pasi situata ndryshon dhe nuk do të mbetet gjithmonë kështu.

Sa i përket në përgjithësi, situatës se sigurisë në komunën tonë e vlerësojmë gjithashtu se prape është e qetë dhe stabile pasi nuk ka ndonjë rast të veçantë që do të ndikon në përkeqësimin e situatës për momentin jo. Tani do të flas për rastet dhe punës policore, ku gjate muajit shkurt të vitit kaluar por edhe këtij viti tani janë regjistruar gjithsej 55 raste gjithsej, ku prej tyre 47 vepra penale dhe 8 incidente të ndryshme. Zbulueshmëria e të gjitha këtyre veprave penale për muajin Shkurt të vitit 2019 ka qenë

28.6% ndërsa për këtë vite ka ndryshuar pak edhe ne rastet penale edhe ne incidentet ku ka zbulueshmeri rreth 35.7%.Ndërsa veç incidenteve nga me te ndryshmet zbulueshmeria e përgjithshme është 87.5%.

Rastet me te renda të regjistruara gjatë kësaj periudhe është rasti në Xerxë pra grabitja e cila ka ndodhur me 27.02.2020 rreth orës 04:05 të mëngjesit nga telefonata që kemi marr ,se ka ndodhur një rast grabitje nga bankomati i cili është i vendosur në qendrën tregtare në QTX, patrullat i janë përgjigjur menjëherë rastit pas pranimit të informatës ku kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë takuar punëtorët e sigurimit në atë qendër ku ishte vendosur bankomati dhe shihet qartë se personat e dyshuar dhe te maskuar ku njeri prej tyre kishte edhe arme të shkurtë(pistoletë) dhe nen kërcënimin e armës ka arritur të vë nën kontroll fillimisht rojën pra sigurimin që ka qenë aty të asaj qendre tregtare dhe dyshohet se është përdorur eksploziv për hapjen e bankomatit dhe të dyshuarit pas hapjes dhe demolimit të atij automati kanë ikur në drejtim të panjohur edhe pse kanë hasur në takim me policinë në Prizren, ku gjate ikjes ka filluar ndjekja deri dikun ne territorin e komunës së Suharekës mirëpo ka qenë e pamundur të kapen, por sido qoftë rasti është duke u hetuar dhe i është dorëzuar drejtorisë rajonale të Policisë në Gjakovë.

Lëndime të lehta trupore kanë qenë 2 raste, ne këtë vitë po flas gjithmonë për muajin Shkurt ndërsa në vitin 2019 kanë qenë 3 raste gjithsej. Vjedhje kanë qenë 6 raste për këtë vite kurse për vitin 2019 kanë qenë 4 raste që ka një ngritje të vogël ndërsa te vjedhjet e renda është një dallim i madhe pasi veç këtë vite kanë qenë 16 ndërsa vitin e kaluar kanë qenë veç 4, por të gjitha këto kanë të bëjnë kryesisht me shtëpitë e pabanuara, faktikisht janë të banuara mirëpo shumica prej tyre janë njerëz gurbetqarë. Të implemtuara gjithsej janë 6 raste operative, nder to edhe kampionati i Kosovës në Basketboll që po na sjell mjaft telashe edhe dëme edhe raste të shumta. Asistimet në total kanë qenë 12 raste, Arrestimet gjate muajit Shkurt kanë qenë gjithsej 7 persona dhe asnjëri prej tyre nuk është ndalur në mbajtje.

Urdhëresat e gjykatave dhe prokurorive për muajin Shkurt 2020 janë realizuar gjithsej 35 urdhëresa.

Gjithashtu gjate muajit Shkurt janë regjistruar 3 vizita të pelegrinëve në Manastirin e Zoqishtit, ku ka pasur 215 vizitorë ku kanë qëndruar për vizitë aty dhe gjatë kësaj kohe janë bërë gjithsej 984 patrullime në afërsi të objekteve të trashëgimisë fetare në Komunën e Rahovecit. Po ashtu shqetësim tjetër edhe në rend dite është edhe trotuari, lirimi i tyre dhe shenjat sinjalizuese, qe po e përsërisim çdo her, kështu që çështja e trotuareve nga Policia e Kosovës pikërisht nga stacioni i Policisë në Rahovec me vite është duke u trajtuar edhe po vazhdoet prapë. Siç jeni në dijeni trotuaret dhe rrugët në qytetin e Rahovecit dallon nga qytetet e tjera për shkak të infrastrukturës, jo të gjitha rrugët plotësojnë e qytetit plotësojnë kushtet për hapësirë të dedikuar për këmbësorë dhe persona me nevoja të veçanta ,edhe ato rrugët të cilat i plotësojnë kushtet faktikisht kushtin pra që kanë hapësirë të mjaftueshme nga ngasës të papërgjegjshmi bllokojnë në mënyra të ndryshme duke mos përjashtuar disa afaristë të cilët me ekspozimin e mallrave dhe gjëseneve të ndryshme para bizneseve të tyre në kundërshtim me ligjin mbi komunikacionin rrugor dhe aktet tjera normative që e rregullojnë këtë çështje.

Policia e Kosovës në baza ditore angazhojnë njësite përkatëse për lirin e trotuareve gjatë vitit 2019 pra njësitë në kuadër të stacionit policor në Rahovec kanë shqiptuar 741 gjoba për parkim në hapësira të ndaluar me ligjin mbi komunikacionin rrugor(në trotuar,hyrje,udhëkryqe etj)ndërsa nga Janari e deri me sot janë rreth 212 gjoba për parkime të tilla, e që ndoshta është shume pak nga ajo se sa janë trotuaret e zëna dhe sa është e cunuar lëvizja. Me funksionalizimin e automjetit bartës(merimangës) vërehet një përmisim i lehtë i gjendjes, mirëpo siç kam theksuar në të kaluarën masat të cilat i ndërmer Policia nuk janë të mjaftueshme pasi mungon vetëdija lidhur me pasojat e veprimeve të këtyre ngasësve dhe afaristeve sepse me këto veprime rrezikohen familjaret tanë, fëmijët tanë të cilët për të shfrytëzuar të drejtën e tyre të lëvizjes së lirë, shpesh herë janë të detyruar të evitojnë pengesat të ndryshme në trotuare.

Andaj shfrytëzoj rastin këtu që të bëj një apel publik nga ju të gjithë pjesëmarrës, te ndikoni në përmasimin e kësaj gjendje në trotuaret e qytetit ndërsa nga zyrtaret përgjegjës kërkoj të reflektojnë në përgjegjësitë e secilit prej neve bazuar në të gjitha ligjet në fuqi duke filluar nga Policia, Inspekcioni,

Drejtoria e Arsimit etj. E them këtë sepse në asnjë vend të botës një dukuri të tillë nuk mund të evitohet me angazhimin e një institucioni por te një pune ekipore do të tregonte rezultat në parandalimin dhe evitim të kësaj dukurie të shëmtuar.

Drejtoria e Arsimit në këtë rast do të mund të jepte kontribut tek rinia/nxënës të cilët në të ardhmen nga kategoria e pjesëmarrës të komunikacion si këmbësor do të kalonte në ngasës.

Drejtoria për Inspektim do të kontribuonte me largimin e gjëseneve pra mallrave të vendosura në trotuare në kundërshtim me ligjin e Trafikut dhe akteve tjera normative.

Drejtoria për Urbanizëm do të mund të kontribuonte me mos pajisjen e këtyre bizneseve për vendosjen gjëseneve / mallrave të vendosura në trotuare në kundërshtim me ligjin e trafikut dhe akteve tjera normative. Prijësit Fetar do të mund të kontribuonin me theksimin e pasojave të kësaj dukurie tek besimtaret, qytetaret, ngasësit, afaristet dhe të gjithë neve të cilët kemi familjaret e këtyre kategorive, më çrast do të përmitohej gjendja e trotuareve.

Vlen të cekët një fakt se përkundër krijimit të disa hapësirave për parkim p.sh. hapësira tek palestra e sporteve që është parking me kapacitet të mjaftueshëm mirëpo shume pak përdoret nga ngasësit për arsye të mungesës së vetëdijes e shume arsye tjera.

Pika tjetër është edhe qentë endacakë që është një dukuri e theksuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe Komunën tonë. Për kundër angazhimit të institucioneve përkatëse të autorizuar nga niveli lokal dhe ai qendrorë gjatë periudhës kohore Janar- Mars 2020 kemi të regjistruar për fatin e keq raste të sulmeve nga qentë endacak si dhe atyre me pronar pa përkujdesje të duhur.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar dy raste të kafshimit pra sulmit nga qentë endacakë si dhe të atyre pa përkujdesje. Me datën 19.01.2020 në fshatin Krushe e Madhe, viktimat burrë e grua janë sulmuar dhe kafshuar nga një qenë i një bariu. Viktimat kanë pësuar lëndime të lehta trupore dhe të njëjtit kanë pranuar ndihmë mjekësore. Rasti është iniciuar dhe është klasifikuar si shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, po ashtu është bërë kallëzim penal dhe është dërguar në Prokurorinë themelore në Gjakovë.

Me datën 23.02.2020 rreth orës 13:30 është paraqitur rasti i kafshimit nga qentë endacakë që ka ndodhur në rrugën „Sadedin Hajda“, viktimë është fëmijë 8 vjeçar i cili ka pësuar lëndime dhe i njëjti është trajtuar në QKMF në Rahovec dhe në spitalin e Gjakovës, por pasi që për këtë rast që qeni nuk ka pasur pronar, Prokurori i shtetit nuk ka autorizuar të iniciohet procedurë. Gjithashtu janë regjistruar edhe disa ankesa lidhur me qentë endacakë në fshatra dhe qytete.

Pika tjetër është siguria në shkollë, që Policia e Kosovës në vazhdimësi e implementon planin e veçantë lidhur me sigurinë në shkollë si dhe projekte tjera që kanë të bëjnë kryesisht lidhur me sigurinë e nxënësve. Gjatë muajit Shkurt 2020 është regjistruar një rast, dhe atë me datë 21.02.2020 në oborrin e shkollës profesionale „Selajdin Mullabazi-Mici“, në Rahovec, ka ndodhur rasti i sulmit ku të përfshirë ishin dy nxënës dhe është iniciuar procedure penale ndaj një të mituri.

Gjatë muajit Shkurt 2020 janë angazhuar patrullat sektoriale duke realizuar 38 vizita në shkollat fillore dhe te mesme, ku është biseduar me personelin përgjegjës të shkollave dhe sipas tyre çdo gjë ka qenë në rregull, pasi është bërë një dukuri relevante pasi çdo herë po përsëritet pas shumë atyre vizitave dhe gjithë atij patrullimi dhe gjithë atyre kontakteve çdo here paraqitet gjendja e rregullt mirëpo në të kundërtën rastet po ndodhin dhe thjesht nuk ka informata.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë mbajtur ligjërata në Qendrën rinore për Delikuencën e të miturve ku pjesëmarrës kanë qenë 30 nxënës të klasës dhjetë, pastaj në OJQ-në „Hareja „për Dhunën në familje ku pjesëmarrës kanë qenë 60 nxënës, pastaj në SHFMU „Bekim Sylka,, rreth Sigurisë së nxënësve në komunikacionin rrugor ku pjesëmarrës kanë qenë 180 nxënës, pastaj në SHFMU „Isa Boletini,,pjesëmarrës 365 nxënës dhe në SHFMU „Gëzim Hamza,, ku pjesëmarrës ishin 180 nxënës, e që duhet të vazhdojmë prapë sipas planeve të parapara tonat dhe rasti mbrëmë që përmendi kryetari ku është ndezë një zjarrvënie në një shtëpi dy katesh afër stacionit të autobusëve ku ka shume thashetheme mirëpo nuk duhet ta vlerësojmë ashtu apo të etiketojmë askënd pasi për momentin nuk

dihet asgjë kështu që ju kisha lut të gjithëve të ju mbetet organeve që ta hetojnë dhe ta ndriçojnë rastin aq sa kanë mundësi pa e etiketuar dhe i shtuar pasi informata po rrjedh shumë shpejt edhe thjesht po shtrembërohet. Unë nuk kam diçka tjetër dhe nëse dikush ka diçka mund të pyesni. Faleminderit kryetar.

Kryetari – Faleminderit komandant hapim diskutimin për çështje që kanë të bëjnë me këtë pikë të rendit të ditës edhe mund të i referohemi edhe paraqitjes së komandantit të stacionit të Policisë.

Ymret Reshiti – Përshëndetje për të gjithë. Unë desha të lidhem të shëndeti i nxënësve pikërisht të Pandemia që është shpallur në nivele të botës. Mjekët e kanë një fjalë ku thonë se më mirë është parandalimi se sa shërimi i sëmundjes dhe fatkeqësisht prej konstatimeve të mjekëve për këtë sëmundje ende nuk e kanë gjetur ilaçin adekuat për shërim dhe vetëm çka mund të bëhet tani është parandalimi.

Vendimi i qeverisë për mbylljen e shkollave është vendim i drejtë dhe ne si këshill i prindërve e mbështesim mirëpo kërkoj nga komuna që këto dy javë të filloj dezinfektimin e institucioneve shkollore dhe kjo është praktike që po ndiqet në çdo vend të botës aty ku është prekur mirëpo sugjerimi im është që mos të ndalet vetëm tek institucionet shkollore por të vazhdohet edhe me objektet shëndetësore, kulturës dhe gjithë objektet tjera publike. E dyta, ne kemi parashtruar si shqetësim vendosja e kamerave afër shkollave të mesme, pasi kemi pasur si shqetësim për arsye se ato kamera mundësojnë përcjelljen e aktiviteteve të dyshimta të përdorimit të narkotikëve e gjërave të tjera që do t'i mbrojmë nxënësit si dhe parandalimi i vozitjeve nga ngasësit me shpejtësinë e tyre gjatë vozitjes e rrezikojnë shëndetin e nxënësve pasi në mesin e tyre ka edhe nxënës që nuk e kanë as moshën 17 vjeçare apo janë të moshës së mitur. Edhe për fund si qytetar po dua të ndaj shqetësimin edhe me juve që thatë më herët, kriza që është krijuar nga bizneset për mungesë të ushqimit në emër të pandemisë. E vërteta është se është presion për me heqë taksën sepse ata dëshirojnë me ju kthye bizneseve dhe përfitimeve që i kanë pasur gjithmonë me Serbinë. Faleminderit.

Ramë Berisha – Përshëndetje të gjithë të pranishmit në sallë. Pak më parë foli për gjëra i nderuari komandanti i Policisë, po ashtu e përmendi edhe për qentë endacakë por unë kisha me thanë jo vetëm për qentë endacakë por edhe për macet që janë të pakujdesshëm prej familjareve me miratua ligjin edhe me i eliminua ato sepse ato nuk kanë kryefamiljar edhe mund të infektohen njerëzit dhe mund të ketë pasojë njerëzimi i Kosovës. Pra ne duhet me u përqendrua me i asgjësua shkaktaret e sëmundjeve sikurse është kjo aktuale por me mujt që para se të lajmërohen shenjat për me i asgjësua ata shkaktarë. Faleminderit

Shqip Shala – Faleminderit kryetar, përshëndetje për ju, nënkryetarin, drejtorat, komandantit dhe gjithë juve të pranishëm në sallë. E uroj komandantin për këtë raport, i cili tregon një ulje të kriminalitetit dhe dukurive negative nga viti i kaluar. Në mbledhjen e kaluar biseduam dhe debatuam rreth punës së lokaleve të natës në komunën tone dhe po ashtu desha me ditë brenda këtyre dy muajve a janë ndërmarrë ndonjë aksion policorë ose të inspektoratit komunal rreth caktimit të orarit të tyre të punës, po ashtu dua të them se dhe unë para 4 viteve nga kureshtja i kam vizituar ato lokale dhe jo për shkak të muzikës por nga kureshtja edhe si gazetar i pavarur edhe pse nuk kam guxuar me u lajmërua si gazetar, që për mendimin tim aty ka gjithçka edhe kontrabandë mundet me pas, narkomani dhe po ashtu mundet me pas që punojnë edhe pa leje të punës që punojnë dhe të gjitha këto lokale, shumica janë në Xerxë dhe aty punojnë edhe valltare që vijnë nga shtetet e huaja dhe krejt çka dua të di është se puna e tyre a është ilegale apo legale?

Sihana Duraku – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë. Atëherë SHL-ja përmes një kërkesë që ka bërë në komunë për rrethimin e shkollave para një viti konkretisht po flas për shkollën „Xhelal Hajda-Toni“, ka filluar ky projekt por ka mbi 2 muaj që projekti është ndërprerë. Pyetja ime është se kur ka me përfunduar ky projekt?

Hoxha – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë dua të bashkëngjitëm në këtë bisedë në lidhje me virusin Covid-19 dhe masat që do të ndërmerren nga organet kompetente dhe normal që duhet të përkrahet nga të gjithë dhe ne si Bashkësi Islame do të jemi në krahë dhe do të

japim kontributin tonë të cilën këna mundësi me dhanë. Edhe ne kemi marr disa masa që fillon nga dita e nesërme pra tubimi i Xhumasë do të jetë me i shkurtër dhe do të dedikohet mbrojtjes nga ky virus dhe masat që duhet të ndërmerren. Unë kisha bërë apel që në rastin kur duhet të ndërmerren hapat dhe aktivitetet e dezinfektimit të objekteve që janë me rëndësi, të përfshihen edhe objektet fetare në këtë rast xhamitë për shkak se aty është frekuentimi i madh i njerëzve dhe ne në të ardhmen do të shqyrtojmë po ashtu ndoshta edhe për kufizimin edhe pjesëmarrjes, nëse eskalon situata shëndeti i njerëzve është para çdo gjëje dhe këtë patjetër edhe ne si institucion fetar do të jemi në nivel të detyrës. Edhe ne i kemi ndërpre aktivitetet mësimore që i kemi nëpër xhami, nga sot është marr urdhri të respektohet vendimi i qeverisë që edhe mësimi shtesë i nxënësve që kanë ardhë nëpër objektet tona të ndërpritet deri ne vendimin që merr qeveria, pra duhet që të gjithë të jemi në komandën zingjirore. Unë kisha ngrit një çështje tjetër jashtë kësaj që kisha ndërmend edhe më herët, e ajo është e disa dukurive dhe aktivitete që po ndodhin në njërin prej vendeve që konsiderohet që janë turistike apo atraktive në qytetin tonë pra është fjala për Majën e Shkodranit. Më ka ndodhur disa herë me shkua me vizitua dhe mendoj se është njëri prej vendeve me te mira që i ka qyteti si peizazhe, pra është vend që meriton që çdo vizitor që vjen me dërgua në atë vend për me pae. Përveç që është vend atraktiv po ashtu është shumë domethënëse për shkak të ngjarjes që simbolizon pra rënia e tre dëshmorëve. Disa gjëra dhe veprime mendoj se nuk na takojnë edhe nuk i japin shije të mirë komunës tonë. Pra unë kam qenë me fëmijë me familje dhe besoni se nuk kam mundur me u afrua afër aty dhe jam detyrua me u kthye, për shkak se në ato tavolina janë servuar pijet alkoolike dhe ishte një atmosferë për të cilën nuk të krijon komoditetin që të afroresh aty. Prandaj ne mendojmë se ajo është pasuri e gjithë qytetareve tonë dhe nuk guxojmë të lejojmë që ajo të uzurpohet nga kushdo qoftë, e në këtë rast këto veprime janë të papranueshme dhe kisha kërkuar nga organet kompetente që të ndërmerren masat qoftë parandaluese apo njoftuese që të ju bëhet me dije se këtë gjest që po e bëjnë nuk është në rregull, që të jepet mundësia që kjo hapësirë të shfrytëzohet nga gjithë qytetarët, e që mendoj që është hapësirë që ja vlen të vizitohet nga të gjithë ata të cilët dëshirojnë me pae qytetin e Rahovecit. Faleminderit

Kryetari – Faleminderit për kontributin e të gjithë diskutuesve, po ashtu faleminderit edhe Komandantit të stacionit të Policisë në Rahovec z. Fazli Morina. Ajo që ishte karakteristike gjate gjithë diskutimeve në piken e dytë të rendit të ditës, për sa i takon gjendjes së përgjithshme të sigurisë në komunën e Rahovecit është që ne duhet të përkushtohemi më shumë edhe te marrim masa parandaluese për tu përballur eventualisht me paraqitjen e Corona virusit qoftë në Republikën tonë apo kudo qoftë por edhe në komunën tonë. Do të punojmë se bashku me Policinë, me drejtorinë komunale të arsimit, me drejtorinë e Shëndetësisë, bashkësitë fetare, me inspektoratin dhe do ta ruajmë një komunikim aktiv me gjitha institucionet e rëndësishme të cilat kanë për detyrë ose kanë përgjegjësi me trajtua me seriozitetin e duhur dhe të kërkuar të situatës që është krijuar. Nuk ka hapësirë për panik por ka hapësirë për përkushtim më të madh, për vullnet më të madh, për organizim më të mirë, për dezinfektim të objekteve shëndetësore, shkollore, publike, fetare dhe të gjitha vendeve ku ka frekuentim me të madhe të qytetarëve. Do të tentojmë të zbatojmë masat preventive të Qeverisë së Kosovës edhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik që të kemi reduktim të aktiviteteve të cilat mund të ndikojnë në zbehjen e veprimeve tona për parandalimin e Corona virusit. Ne tërheqim vëmendjen edhe vërejtjen për bizneset të cilat do të kërkojmë që e thanë edhe të tjerët po ashtu e thashë edhe unë në fillim, që ne do të mbajmë një evidencë se cila është arsyeja që të hidhemi që në një farë mënyre kundër popullit tënd, me aq nguti ,egërsi apo përkushtim edhe të shkojmë ne dyfishim apo trefishim të çmimeve. Nuk du me i dhanë asnjë konotacion, e kuptoj se tregtia është tregti mirëpo nuk është mirë në situata të tilla që tregtarët të bëjnë veprime të cilat nuk i bëjnë krenar ata për punën që e bëjnë të bazuar ndoshta në ligje të aplikueshme të Kosovës. Po ashtu që ne do të mbledhim shënime dhe do të shohim se si do të veprohet edhe ne komuna tjera të Republikës së Kosovës, jam shumë i bindur që nuk do të ketë kufizime në tregti për shkak se tregtia do të vazhdojë, kështu që nuk ka asnjë arsye dikush me u furnizua pa nevojë kaq shumë sepse edhe kjo situatë është e kalueshme dhe e përballueshme, bile ne jemi të bindur se shumë shpejt do të kalojë sepse ka filluar me u izolua, sepse

ka shenja edhe aty ku është paraqitur d.m.th. nuk ka raste të reja sikurse ishte në fillim, por sidoqoftë kjo situatë kalon dhe dikujt do t'i mbetet turpi në këtë vend që shfrytëzojnë situata të tilla për përfitime të thjesht individuale dhe atë kundër popullit tënd pra qytetareve tonë. Unë po besoj që ka furnizime të mjaftueshme, po ashtu ka me pas edhe në ushqime edhe ne gjithçka pe shkak se tregtia nuk u ndal as në kohën e luftës e leje më tani, por theksi ra te çmimet e larta dhe ne duhet ta ushtrojmë ndikimin tonë, të komunikojmë me njerëz dhe të ju themi që duhet të keni turpe për veprimin që bëjnë, nëse vërtet janë të këtij vendi, por nëse janë te ndonjë vendi tjetër që dëshirojnë me dëmtua atëherë është krejt diçka tjetër, por bilum njerz të tanë duhet me pas të qartë nuk është mirë me veprue në situata të tilla kur kërkohet mobilizimi i të gjithëve pra organizimi, vullneti, solidariteti, humanizmi i njerëzve të këtij vendi, pasi njerzit e kanë dhanë jetën për këtë vende ku mbi 1000 persona ka të vrarë e të masakruar e të pagjetur komuna jonë, edhe nuk ju vjen turp me i ngritë çmimet brenda 24 orëve.

E dini që nuk e kam hallin për vete se tek e fundit me u shit kaq shpejtë mielli pastaj produktet ushqimore vërtet kjo është e papranueshme sikur të bëhemi gati për luftë dhe mos të harrojmë se Kosova ka rezerva shtetërore po ashtu edhe ligje për rezerva shtetërore pastaj ka një marrëdhënie të shkëlqyer me plot aleatë edhe partner që i dalin në ndihmë dhe nuk jemi në situatën e tillë që të bëjmë çka të mundemi e te flasim çka të na vjen te goja e te veprojmë çka të na vjen te dora, kjo nuk është ne rregull dhe po besoj që bashke me inspektoratin do të shohim se paku të kemi një evidencë për të ardhmen.

Qentë endacak edhe njëherë po e përsërisë faktin u ngritë, tip konkluze që duhet ta diskutojmë dhe mirë që po e diskutojmë çdo takim, nuk janë përgjegjësi e komunës fatkeqësisht, pasi është përgjegjësi e AVUK-ut (Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës) dhe është përgjegjësi e operatorëve që kanë marrëveshje apo kontratë me AVUK-un. Ne në bazë të disa informatave të cilat ne i kemi thuhet që janë vaksinuar, trajtuar etj. dhe nuk ka rrezik mirëpo nuk është për t'iu besuar kësaj pune për shkak se mundem me u shtua kur ka mbeturina dhe ne nuk mundemi me dit se çka ka ndodhur dhe çka mund të ndodhë. Si do qoftë ne i kemi prezentë qentë endacakë edhe sheshe, në rrugë, në oborre të komunës fatkeqësisht, afër shkollave, afër vendeve të frekuentuara, që veç i tha edhe Komandanti se i kemi 3 raste këtë vite që kemi kafshime nga qenët endacak edhe një fëmijë, po ashtu kemi edhe qenë pa pronarë fatkeqësisht që janë ne rrugë dhe ne nuk e dimë për masën e rrezikut ose të kërcënimit që mundet me ardhë për shëndetin e njerëzve nga kafshimi i qenëve endacakë. Ne do të ri trajtojmë edhe njëherë, qeverisë do t'i drejtohem pas i nuk kemi ne kompetenca dhe përgjegjësi pasi fatkeqësisht na kanë marrë pra i kanë centralizua përgjegjësitë edhe nuk varet shumë nga ne. Prej neve varet ngritja e shqetësimit edhe ripërtëritja e kërkesës e presionit për me muajt me bo diçka me ndryshe ose ma shume që me pas mundësi edhe komunat që me muajt me bo bashkë me AVUK-un në këtë drejtim. Te çështja e pezullimit të lejeve për lokalet e natës, unë e di që këtu e kemi marrë një vendim pra një rekomandim dhe unë menjëherë kam veprua dhe e kam dërgua në Zyrë Ligjore. Ne kemi pak një konflikt me ligjin pasi kemi një pengesë por jemi duke shqyrtuar mundësinë që sa më parë me dalë me pezullua lejet për lokalet e natës dhe decidivisht po e them unë jam shumë i interesuar me u zbatua rekomandimi apo vendimi i KKS-së dhe të gjitha raporteve të policisë, pasi Shaipi nuk është që zbuloj diçka pasi ato po dihen, mirëpo nuk po e di se Shaipi a ka shkuar aty si gazetar apo si ka shkuar, por duhet me u rujt pasi ato janë në monitorim pasi dihet se në ato lokale nuk ka ndonjë veprimtari që mundet me na bo krenar neve edhe sigurisht edhe ata që janë pronar të lokaleve edhe të njerëzve që shkojnë aty pasi nuk i dihet hiq kësaj pune pasi me nje operacion edhe mund të shkojnë nëpër burgje njerz të që merren me narkomani dhe çfarëdo vepra tjera kriminale të cilat janë në kundërshtim me ligjet tona. Unë po besoj që gati ja kemi mbërri qëllimit dhe shpresoj që do të kemi shpejt një vendim nga Zyra Ligjore, sigurisht që do të kemi shumë shpejt edhe Rregulloren për taksa komunale në Kuvend të Komunës se Rahovecit dhe unë jam i gatshëm që edhe pa e pritë aprovimin e rregullores se re me ndryshim plotësime, pasi me insistim kam kërkuar prej 5 zyrtarëve ligjorë që i kemi, që me i gjet bazën e mirëfillte ligjore për me ardh deri te një vendimmarrje për me i pezulluar lejet për lokalet e natës ku do qofshin ato, ndoshta ka edhe në pjesë tjera të Komunës do të jemi të interesuar me i

ndërprerë ose me pezullua aktivitetin në orar të caktuar prej ore 23:00-04:00 të mëngjesit. Unë e di që pa leje pune askush nuk operon, ndoshta pa leje pune operojnë disa a varreza të automjeteve që i keni parë që po i largojmë, edhe kjo ka qenë një kërkesë edhe e Policisë, edhe e jona e po ashtu edhe KKSB-së në plotë debate, edhe e keni pae që kanë filluar me u liruar ato hapësirat në komasacion pasi i kemi urdhëruar me i larguar, sigurisht që kemi pasur problem rreth kësaj por ne jemi ardhë këtu për me krye punë sepse ka vështirësi në këtë proces, po ashtu jemi të interesuar ne vazhdua rrethimin e objekteve të shkollës pra të oborreve të objekteve shkollore mirëpo ka skaduar kontrata me kompaninë e cila me shumë ka qenë kompani fiktive se sa funksionale dhe ne sivjet e lidhim kontratën e re pasi prej asaj kompanisë nuk pritët asgjë, ka skaduar kontrata dhe mirë që ka skaduar pasi krejt punët i ka lanë përgjysmuara pasi kemi pasur vazhdimisht telashe që nga viti 2016 neper të gjitha shkollat, tani mirë që na është hapur rasti që me fillua me procedurë të re për rrethim të objektit të shkollës në Xhelal Hajda-Toni në Rahovec.

Te trotuaret – ne jemi duke vazhduar projektin e ndërtimit të trotuareve aty ku kemi mundësi por Komandanti foli edhe për çështjen që po ngritët në çdo takim të KKSB-së, është lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike. Është e vërtetë që ka më shumë aktivitete dhe suksese në lirin e hapësirave publike por përsëri kemi telashe dhe kemi disa zona që vazhdojnë të qëndrojnë për muaj të tërë makinat në trotuare dhe kjo është e vërtetë edhe unë e ftoj Policinë e Kosovës edhe Auto bartjen që e kemi në kontratë që mos të falin në asnjë mënyrë askënd hiq, pasi më mirë është me nervozua dikë edhe me i humb disa poena për shkak se dikush edhe të kundërshton ju e dini por me shpëtua ndonjë rast me fatalitet nesër që s'kemi qef pastaj me na raportua komandanti këtu dhe unë jam për me i liruar trotuaret dhe hapësirat publike kudo që ka shkelje. Ka disa përmirësime në pjesën poshtë stacionit të autobusëve por përsëri ju veç i keni parë ato hekurishtet që kanë filluar me i lirua trotuaret por ne i kemi një anomali pasi edhe trotuaret janë në pronë të atyre hekurishteve pra pronë private dhe ne po duhet tash me i bo disa veprime shumë të kujdesshme që mos me ardhë me nxan edhe rrugën ndoshta dikush ka edhe pronë private pasi e kemi shikuar edhe me kadastër por jemi mirëkuptuar i kemi kryer disa punë dhe se paku hekurishtet nuk kanë me qenë në trotuare dhe kanë me qenë rrethojat që se paku i japin një imazh me të mirë asaj pjese të qytetit.

Ekspozimi i mallrave në trotuare po ashtu një problem tjetër që u ngritë, që po ashtu një konkluzë e këtij takimi, ne do të ndalojmë ekspozimin e mallrave ushqimore në hapësirat publike, jo pse na ka thënë dikush por për shkak se është e pakuptimtë, ne qoftë se besojmë që mallrat ushqimore ekspozohen në hapësirat publike a janë cilësorë të shëndetshme apo jo. Ndërkohë që do t'i luftojmë ata që i ekspozojnë mallrat tjera në hapësirat publike që skanë leje punë pra që skanë leje për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike. Jemi duke bërë disa veprime dhe unë ju sigurojë gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë qytetaret se tash e kemi edhe depon e cila do të mbushet me mallra të konfiskuara nëse ekspozohen në kundërshtim me rregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike. Pra kjo këtu që dikur ka qenë byfe, është një depo jashtëzakonisht e përshtatshme edhe ka kapacitet të mjaftueshme për mallra pra edhe në pikëpamje të ligjit edhe me inspektorët e kemi të rregulluar edhe këtë. Kush ka interes me ju konfiskuar malli, ne jemi të gatshëm me ja konfiskua edhe jemi të gatshëm edhe me hije në veprime edhe më serioze edhe nëse ka lojërë të fatit në mënyrë ilegale edhe çdo gjë që është në kundërshtim me ligjin do të jemi të gatshëm absolutisht pa asnjë lloj frikë, pasi ne i frikohemi vetëm përgjegjësive të ligjit. Unë personalisht jam i gatshëm edhe si kryetar komune krejt operacionet e mundshme për me i luftuar të keqen, me i marr bashkë me akterët që janë kompetent edhe mu përfshi direkt në kuadër të përgjegjësive tona me i luftuar keqbërësit që e shkelin ligjin në komunën e Rahovecit pra për komunën tonë. Nuk jemi të interesuar për 20 persona me prish imazhin e 60,000 banoreve, kushdo qofshin ata, kjo vlen edhe për te Maja e Shkodranit, ne nuk mundemi të ja ndalojmë ndoshta krejt gjërat por po harrojmë se ne kemi vendosur disa kamera të sigurisë atje, unë isha dje aty dhe është shqetësuese, qysh dikush edhe kamerën e ka kthyer nalt që mos me pae dikush që janë përmendoret pra pllakat përkujtimore të dëshmorëve. Dikush ka shkuar edhe e ka këput me sharre shtyllën e ndriçimit publik, dikush i ka hekë edhe monumentet e kështjellës, rrastat që e mbrojnë prej

shirave që janë mbulojë e atyre mureve atje. Të gjitha i kam parë vet, isha edhe me nënkryetarin dhe me drejtorin e drejtorisë përkatëse. Unë po ju premtoj publikisht, se në momentin kur të gjenden kryesit e këtij veprimi të shëmtuar, do të kenë probleme jo vetëm me ligjin por edhe me administratën e komunës e mos të flasim edhe me organet e tjera. Nuk e di si nuk ju vjen marre me shku me këput shtyllën e ndriçimit publik, me dëmtuar tavolinë që munden me qëndruar familjarët, me i dëmtuar pllakat e dëshmorëve kur e dimë që as eshtrat nuk kemi mundur me ju gjet dhe në atë vend me shku me prek dikush edhe me bo veprime të palejuara, po harrojnë se aty ka kamera të sigurisë, pasi ai vend është i mbrojtur tash, ne e kemi shtie edhe në mirëmbajtje tash pasi pastrohet dy herë në javë, do të rritet angazhimi jonë për me rritë mirëmbajtjen në atë vende, do të shtohen kapacitetet ose numri i njerëzve që do ta vizitojnë atë vende. Unë nuk e di se kush janë ata edhe nuk është detyrë e imja me ditë por me shkua edhe njëherë po e them me preh me sharrë shtyllën e ndriçimit publik, me largua tavolinën prej aty, me i thye ato pllakat sinjalizues, ndaj këtij elementi nuk ka pardon, ky vend ka kaluar luftën, e ka fituar lirinë, e ka bo shtetin edhe ky shtet nuk mundet me u sfiduar prej njerëzve që kanë ngarkesa apo mbingarkesa psikologjike pasi këta njerëz duhet me shkua me u vizituar te psikiatri për veprimet e tyre. Unë pajtohem me Hoxhën se aty ka vizita familjare pasi njerëzit shkojnë aty për vizitë e jo me dëgjuar veprime të këqija aty apo muzikë pasi nuk është vend që lejon me bo çfarë të duash, pasi ajo është zonë e mbrojtur, zone turistike, zonë përkujtimore dhe në Kuvendi i komunës nuk ka lejua me ju dhanë askujt asgjë aty, ndoshta mundet ne të ardhmen vetëm për një kioskë aty, pra nuk ka lejua kurrëgjë mu bo aty, për shkak se pak më lartë është kalaja e Durmanit dhe kjo hapësirë duhet të shfrytëzohet racionalisht dhe është hapësirë për të gjithë dhe nëse janë krijuar kushtet për me u shfrytëzua për të gjithë atëherë nuk ka të drejtë dikush me shfrytëzua vetëm për vete dhe nuk është me rëndësi interesi i atyre tjerëve se çka bëhet me ata. Ne do ta monitorojmë edhe me shumë edhe do të shohim se çka na thonë kamerat e sigurisë, çfarë pasqyrë po na japin dhe kush janë ata që i bëjnë këto sene. U fol për dezinfektimin e objekteve publike, ne do ta negociojmë këtë, unë duhet me ju thënë se ne nuk kemi për momentin kontratë por në rast të tilla, ne kemi një nënë aty në ligje të prokurimit që ndoshta mund ta negociojmë që të lidhim një kontratë me një kompani të specializuar që tash rishtazi e bën dezinfektimin e krejt atyre objekteve për të cilat folëm, normalisht që do ti kushtojmë kujdes edhe objekteve fetare sepse ka frekuentim të madh të njerëzve por edhe objektet shkollore, kulturore, te administratës, të shërbimit shëndetësor, te gjendjes civile pra ofiqarit, të gjitha do të dezinfektohen pra ndoshta atje te stacioni i autobusëve pra kudo që ne vlerësojmë që është rëndësi me u dezinfektua atëherë edhe do të bëjmë edhe këtë punë. Nuk e di ditën se kur bëhet kjo punë për shkak se neve na duhet një procedurë ndoshta jo shumë e gjatë por një procedurë për me legalizua projektin e dezinfektimit të objekteve publike. Unë s'po shoh se ka këtu diçka tjetër, ju falënderoj shumë dhe me këtë po e mbylli pikën e dytë të rendit të ditës, me besimin që në takimin e ardhshëm do të kemi më pak kriminalitet qoftë individual apo të organizuar edhe me pak zhvillime të cilat do të provojmë që komandanti me pas rast me na tregua për raste që i dëgjuam bashkë. Faleminderit shumë!

E kemi piken e tretë te rendit të ditës, po e njoftojë KKSB-në, ne se shpejti do të mbajmë një takim me kryetaret e lagjeve të qytetit dhe të këshillave të fshatrave, edhe kjo është sipas planit vjetor të KKSB-së dhe aty do të diskutojmë për të gjitha temat që janë me interes publik dhe që mund të adresohen si shqetësime kryetarët e lagjeve, këshillat e lagjeve, kryetarët e fshatrave, këshillat e fshatrave edhe do të debatojmë këtu. Pra është një pikë që kërkohet nga ne me përmbushë planin vjetor të KKSB-së dhe pastaj do të njoftohet KKSB-ja se çfarë konkluda do të mbërrihen në takimin me kryetaret e lagjeve dhe të fshatrave të Komunës së Rahovecit. Atëherë nëse keni diçka në të ndryshme mund ta thuani, po urdhëroni komandantë.

Komandanti Fazli Morina – Veç desha me plotësua pak tek lokalet e natës që mos të ju mbetemi borxh. Është shumë e vërtetë që janë tri rekomandimet që kanë dalë me herët nga ky takim këtu, ekspozimi i mallrave, përcjellja e funeralit dhe lokalet e natës në Xërxe. Po dëshiroj me ja bo me dije edhe të nderuarit gazetar dhe gjithë të tjerëve se nuk ka munguar angazhimi pasi është duke u vepruar çdo herë në Xërxe. Nga takimi i kaluar obligimi im ishte të ju raportoj çdo herë personalisht

drejtpërdrejt rreth situatës prej kërkesave që janë bërë në Xerxe mirëpo është punuar rregullisht dhe është në vëzhgim ne përcjellje çdo sen ndoshta është deshtë me thirre edhe gazetarin pasi ne nuk jemi gjithmonë në uniform pasi ka edhe njerëz të tjerë brenda kaniherë ndoshta kishim pas mundësi me pae edhe gazetarin aty edhe me pyet se pse ka shkua dhe çfarë është puna. Pra ka qenë situatë e qetë dhe nuk ka asnjë rast apo incident prej marrjes se vendimit që[është kërkuar kështu që nuk kemi pasur nevojë me raportua asnjë sende pasi nuk ka asnjë incident ma të voglin që ka ndodhur deri me tani në lokale, pa e përjashtua mundësinë që është diskutuar që të ndërmerren masat kështu që diçka tjetër nuk kam.

Kryetari – Faleminderit shumë të gjithëve për kontributin, angazhimin edhe do të shihemi në takimin e ardhshëm, shpresoj më pak ngjarje të cilat do të detyrohem ndoshta me u marr. Faleminderit edhe prej pjesëtarëve të Ushtrisë së Kosovës dhe gjithë vëzhguesve dhe anëtareve të KKSB-së.

Mbledhja përfundoj në 11:30

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi